

FJALA E DEPUTETIT EDUARD NDRECA

E ENJTE 21 PRILL 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Fort të nderuar qytetarë,

Akti normativ i paraqitur sot nga Këshilli i Ministrave, pasi ka kaluar të gjithë filtrin e debateve në komisioneve, përveçse në zbatim të Kushtetutës, është edhe një akt moral i kësaj qeverie për t'u shërbyer qytetarëve në këto kohë krize, e cila na është imponuar në rrethana të reja ndërkombëtare, që të gjithë i dimë, jo vetëm krizë çmimesh, por edhe e mungesës së mallrave ushqimore. Siç e tha edhe nismëtari, qëllimi i këtij akti është kufizimi i përkohshëm i çmimit të disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së vështirë të krijuar në treg.

Jemi në kushtet e emergjencës dhe nevojës, ndaj një hap i tillë është i duhuri për të ndikuar sadopak në minimizimin e pasojave të krizës te qytetarët, kjo nëpërmjet miratimit të një liste ushqimesh për të cilat do të zbatohet situata e veçantë, qoftë në çmim, qoftë te marzhi i fitimit për qytetarët. Vetë nenet e këtij akti janë pasqyra si ky mekanizëm do të funksionojë, që nga përcaktimi i mënyrës së kufizimit të çmimeve, kriteret për përcaktimin e situatës së jashtëzakonshme, ngritja e bordit të transparencës dhe monitorimit, strukturat që do të zbatojnë vendimet e bordit dhe deri te ndëshkimi i atyre që abuzojnë me këto vendime. Nuk dua të ndalem më tej, sepse e shpjegoi dhe ishte mjaft shteruese ministrja dhe të gjithë diskutantët para meje, por dua të them se në thelb ky akt synon rregullimin e një marrëdhënie të re mes blerësit dhe shitësit, të dy të ekspozuar maksimalisht ndaj kësaj krize.

Në këtë rast shitësi do të jetë ai që duhet të tolerojë në maksimum dhe ta shikojë si një situatë kalimtare krizën e fitimit të munguar, jo si një tregtar egoist, të cilit i intereson veç fitimi i tij dhe asgjë tjetër. Jo vetëm në Javën e Gjelbër, por unë jam çdo ditë në Lezhë dhe diskutoj me qytetarët dhe banorët atje, me parti dhe pa parti, madje enkas për këtë qëllim kam bërë edhe një tur takimesh në njësitë e bashkisë së Lezhës, në çdo fshat dhe qytet. Për të thënë të drejtën, jam suprizuar nga mënyra si tregtarët e shikonin këtë situatë dhe kishin gatishmërinë e plotë për të hequr dorë nga fitimet e zakonshme dhe për t'u shërbyer bashkëqytetarëve të tyre në çdolloj forme e mënyre që ata të mos rëndoheshin edhe më shumë nga kjo krizë. Një lloj solidariteti që më ka lënë mbresa.

Për shembull, një shitës ushqimesh në Zejmen të Lezhës më tha se kishte hequr dorë nga fitimet e produkteve të mallrave kryesore ushqimore. Kur e pyeta pse e bënte këtë gjë, më tha: "Në këto 20 vjet që unë punoj me këtë tregti janë këta banorë që më kanë ndihmuar me blerjet e tyre të jetoj, të ushqehem, të bëj shtëpinë, të shkolloj fëmijët e unë është minimalja që mund të bëj për ta në këto kohë krize". Ky është shqiptari i vërtetë, ky është solidariteti, i cili, fatkeqësisht, mungon në këto karriget e ftohta të parlamentit. Megjithatë, nuk duhen lënë pa përmendur edhe raste abuzimesh, sepse patjetër

që ka, dhe duhet t'u kushtojmë një vëmendje shumë të madhe tregtarëve të shumicës, të cilët nëpërmjet abuzimit që mund të bëjnë ndaj shitësve të vegjël e çojnë rrjedhimisht abuzimin te qytetari.

Po ashtu, dua të them se fjalët e qytetarëve rreth kësaj krize çmimesh dhe e rëndesës që ata kishin ishin leksione të së vërtetës. Në fakt, në fillim kisha pak druajtje, sepse thashë, kur në parlament një dynja deputetësh fajësojnë qeverinë për këtë krizë, çfarë nuk do të më dëgjojnë veshët kur të shkoj në fshatra e në qytet, por, përkundrazi, banorët e lodhur nga kjo krizë e kuptonin më mirë se askush se kjo nuk ishte në dorën e qeverisë dhe nuk gjeta kund asnjë fjalë fyese dhe akuzuese ndaj qeverisë. Patjetër, ata ndanë me mua, sikurse e bëjnë çdo ditë, vërejtje për shumë gjëra që nuk i kemi bërë si duhet apo për gjëra që nuk i kemi bërë, për të cilat duhet folur dhe ngritur zëri vazhdimisht, por kurrsesi të na fajësonin për çmimet, madje falënderonin qeverinë për ndërhyrjen që ka bërë në mënyrë që mallrat e shportës të blihen me çmimet më të mira të mundshme.

Normalisht, nuk fajësohen qytetarët, sepse ata nuk janë politikanë që foltoret e tyre i përdorin për propagandë dhe shown e radhës. Gjatë këtyre bisedave u binda se ata nuk e marrin të gatshme atë që recitojmë ne këtu, por bëjnë vlerësime, e selekcionojnë dhe reagojnë vetëm kur kanë baza, jo më nga thirrjet politike. Kjo është një kampanë alarmi për opozitën, mbi të gjitha, për të ardhmen e saj, sepse mund të zgjidhë krizën e brendshme, por e ka të vështirë, me të pavërtetat që thonë, të zgjidhin krizën e raportit të tyre me qytetarët. Ndaj, u bëj thirrje kolegëve që zbresin këtu me gjuhën e të pavërtetave: kultivoni të vërtetën, se po largoheni çdo ditë e më shumë nga mendja, zemra e banorëve të këtij vendi, dhe pastaj as për protesta nuk do t'ju vijë askush, madje as anëtarët e partisë suaj.

Ngritja e bordit të transparencës për mua përben kulmin e këtij akti normativ, madje mendoj se ky bord apo një i ngjashëm me të, duhet të funksionojë në çdo kohë, në kohë lufte dhe në kohë paqeje, në kohë krize dhe kur s'ka krizë, sepse në çdo kohë dje, sot, nesër dhe gjithmonë do të ketë familje që krizën e jetesës do ta kenë prezentë në sofrat e tyre, kështu që çdo abuzim nga tregtarët do ua vështirësonte më tepër jetën, ndaj ky lloj bordi duhet të funksionojë në çdo kohë. Duhet të vijë koha kur asnjë tregtar për asnjë produkt, nuk duhet të luajë me çmimet sipas dëshirës së tij. Loja e çmimeve në Shqipëri është shumë më e rrezikshme në kohë paqeje sesa në kohë lufte, ndaj u duhet vënë fre një herë e mirë orekseve të tepruara të disa tregtarëve që luajnë "arushën" me çmimet, siç thonë nga Shkodra, kjo gjasje në emër të ekonomisë së tregut të lirë, e cila veç e lirë nuk mund të jetë, kur abuzohet me të.

Së fundi, u bëj thirrje kolegëve të mos e përdorin këtë foltore as për panik, as për të bërë luftën e tyre politike me ushqimet jetike të shqiptarëve. Kemi plot të tjera, edhe në mos paçim mendje brilante që janë mësuar me sherrin në këtë Parlament, që fatkeqësisht e pamë edhe sot, që do të gjejnë ndonjë sebeb për të bërë sherrin e madh politik. Kohërat e krizave duhet vetëm të na bashkojnë. U tha në fillim nga një kolege e opozitës se ne vazhdimisht përmendnim tërmetin, pandeminë dhe krizat e të tjera. Po, duhet t'i përmendnim dhe t'i përmendim me forcë, se një qeveri që përballon krizat e befasishme meriton vlerësimin maksimal edhe të atyre që janë kundër saj me bindje, se nuk e teproj po të them që duhet të ishin pranë nesh dhe të kontribuonin me mendjen e tyre, zemrën dhe angazhimin, kudo në zonat e tyre elektorale, për t'ju bërë krahë qeverisë për ta përballuar këtë krizë.

Megjithatë, për të shkuar pak më tej, u them kolegëve të opozitës se nuk kemi përballuar vetëm këto kriza, edhe këtë që po e përballojmë me shumë sukses, deri tani të paktën, por kemi përballuar edhe një krizë tjetër, krizën që latë pas ju në vitin 2013. Ishte një krizë ekonomike, një krizë e brendshme dhe ndërkombëtare ndaj këtij shteti, krizë e borxheve të brendshme dhe të jashtme, përballë një arke shteti bosh, të mjaftueshme të gjitha këto për të krijuar një kaos ekonomik, kështu që duhej bërë punë e madhe, që këtij shteti t'i vinte era shtet. Përballimi i kësaj situatë dhe vënia e shtetit në linjat e duhura të funksionimit ka qenë kriza më e madhe që ne kemi përballuar. Krizat janë fatkeqësi, si tërmeti dhe pandemia apo edhe kjo që po ndodh sot. Ato ndodhin, kanë ndodhur dhe do të ndodhin. Gjithsesi, ajo që ka bërë kjo qeveri për t'i përballuar këto kriza duhet vlerësuar maksimalisht.

Ta imagjinojmë një herë sikur, fatkeqësisht, këto kriza të kishin ndodhur para vitit 2013, çfarë do të kishte ndodhur? Nuk dua të zgjatem dhe të citoj ato që kam shkruar, sepse nuk më duket e arsyeshme në këtë orë të vonë, megjithatë them me bindje se vetëm ndonjë komitet teknikësh për të përballuar këtë krizë nuk do kishte. Patjetër, do të kishte parti në funksion të shërbimit të anëtarëve të saj edhe në kohë krize, por kurrsesi nuk do të kishte angazhime me borde dhe komitete për të përballuar krizat. Megjithatë, çdo e keqe e ka një të mirë. Edhe krizat që ndodhën patën të keqen e madhe, se rënduan së tepërmi banorët e këtij vendi, por e mira e tyre është se nuk ndodhën kur ju ishit në pushtet. Fatmirësisht, sepse çfarë s'do na kishin parë sytë dhe çfarë s'do na kishin dëgjuar veshët! Faleminderit!